

LIGJ
PER NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN E LIGJIT TE SHERBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE
AUDIOVIZUALE

Neni 1

Ne Ligjin e Sherbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13; 13/14; 44/14; 101/14; 132/14; 142/16; 132/17; 168/18; 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23) ne nenin 3 pika 31, lidhja "dhe" ne fundin e fjalise zevendesohet me pikepresje.

Ne piken 32, pika ne fund te fjalise zevendesohet me lidhezen "dhe".

Pas pikes 32, shtohet nje pike e re 33, e cila behet:

"33. Fushata shtetere eshte komunikim me publikun me mesazhe ekskluzivisht informativiedukative dhe i drejtohet nje numri te madh njerezish ne nje periudhe te caktuar kohore, me qellim per te gjeneruar rezultate specifike ose per te arritur qellime te paracaktuara, ndersa publikut i sigurohet informacionet t nevojshme per arsyen e nje fushate shtetere. Temat qe lidhen me veprimtarite politike dhe diplomatike, temat qe promovojne sherbimet ose politikat e organeve te pushtetit shtetor ose vendor ose temat qe lidhen me veprimtarite partiake nuk lejohen ne fushaten shtetere dhe gjate zbatimit te fushates shtetere nuk mund te perdoren emrat e partive politike, sloganet partiake, simbolet apo shenjat, per t'iu referuar aktiviteteteve te partive politike, ne faqet e tyre te internetit, publikimet dhe materialet e tjera dhe per te promovuar anetaret e Qeverise se Republikës së Maqedonisë së Veriut ose perfaqesuesit e organeve te tjera te administrates shtetere dhe te njesive te veteqeverisjes lokale".

Neni 2

Ne nenin 48, ne paragrafin (1), pas fjaleve "videospotet ose" shtohen fjalet "audio dhe".

Ne paragrafin (2) pas fjaleve "videospote ose" shtohen fjalet "audio dhe".

Neni 3

Ne nenin 56, paragrafi (2) ndryshohet sic vijon:

"(2) Me fleteparaqitjen sipas paragrafit (1) te ketij neni, dorezohet pershkrim teknik me karakteristika teknike te detajuara per menyren se si do te ofrohet sherbimi dhe nese ofruesi i sherbimeve mediatike audiovizuale eshte person juridik dhe gjedhe nga Regjistri Qendror."

Paragrafi (3), ndryshohet dhe behet:

"(3) Nese fleteparaqitja sipas paragrafit (1) te ketij neni nuk eshte i plote, Agjencia e njofton aplikuesin me shkrim qe ta plotesoje dhe ta dorezoje ne afat prej 10 ditesh nga dita e pranimet te njoftimit".

Ne paragrafin (4) fjalet "paragrafet (3) dhe (4)" zevendesohen me fjalet "paragrafet (1) dhe (2)".

Ne paragrafin (5) fjalet "paragrafi (5)" zevendesohen me fjalet "paragrafi (3)", ndersa fjalet "paragrafet (3) dhe (4)" zevendesohen me fjalet "paragrafet (1) dhe (1) dhe (2)".

Neni 4

Ne nenin 57 paragrafi (1) paragrafi 1 ndryshohet dhe behet:

“- ndermarrja dhe selia, nese ofruesi i sherbimeve mediatike audiovizuale sipas kerkeses eshte person juridik, gjegjesisht emri dhe mbiemri, nese ofruesi i sherbimeve mediatike audiovizuale eshte person fizik, si dhe emri dhe mbiemri i personi pergjegjes i ofruesit te sherbimeve audiovizuale sipas kerkeses”.

Neni 5

Ne nenin 79, paragrafet (2) dhe (3) fshihen.

Pas paragrafit (4), i cili behet paragrafi (2), shtohen dy paragrafe te ri (3) dhe (4), sic vijojne:

“(3) Licenca per transmetim televiziv ose radio mund te vazhdohet me kerkese te mbajtesit per nje periudhe nentevjecare. Kerkesa dorezohet ne Agjenci, jo me shume se gjashte muaj para skadimit te lejes. Keshilli i Agjencise duhet te marre vendim ne afat jo me te gjate se 30 dite, nga dita e pranimet te kerkeses per vazhdimin e licences, nese radiodifuzuesi nuk ka bere shkelje ne pajtim me paragrafin (4) e ketij neni.

(4) Keshilli i Agjencise merr vendim per refuzimin e kerkeses pe vazhdimin e licences nese radiodifuzeri gjate kohezgjatjes se licences ka kryer shkelje te renda, perkatesisht:

- te pakten tri here gjate kohezgjatjes se lejes e ka shkelur ndalesat e vecanta sipas nenit 48 te ketij ligji, per te cilat ka vendime gjyqesore te formes se prere, ose
- Gjate kohezgjatjes se lejes, te pakten ne nje cikël zgjedhor, mbulimi mediatik nuk eshte bere ne menyre te drejte, te balancuar dhe te paanshme, per te cilen ka vendime gjyqesore te formes se prere.

Neni 6

Pas nenit 101 shtohen dy kapituj te ri, Kapitulli V-a FUSHATA SHTETERORE NE NIVEL SHTETEROR dhe gjashte nene te rinj 101-a, 101-b, 101-c, 101-d, 101-e dhe 101-f dhe Kapitulli V-b FUSHATA SHTETERORE. NE NIVEL LOKAL dhe gjashte nene te rinj 101-g, 101-h, 101-i, 101-j dhe 101-k, sic vijojne:

“Kapitulli V-a FUSHATA SHTETERORE NE NIVEL SHTETEROR

Fushata shtetere ne nivel shtetor

Neni 101 - a

(1) Qeveria e Republikes se Maqedonise se Veriut gjate nje viti kalendarik realizon se paku nje fushate shtetere ne nivel shtetor.

(2) Mjetet e marra nga fushatat shtetërore në nivel shtetëror mediat i shfrytëzojnë për digjitalizimin dhe avancimin e procesit të punës, si dhe për përmirësimin e standardit dhe kushteve të punëtorëve mediatike.

(3) Mediet janë të obliguara që për vitin paraprak të dorëzojnë raport financiar në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe të Administratës më së largu deri më 31 mars të vitit aktual. Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës është e detyruar të përgatisë raport për fushatën shtetërore të realizuar në nivel shtetëror dhe mjetet e shpenzuara, si dhe ta publikojë në faqen e saj të internetit- jo më vonë se 31 maji i vitit vijues për vitin paraprak.

Komisioni i vendimmarrjes për fushatat shtetërore në nivel shtetëror

Neni 101-b

(1) Komisioni i vendimmarrjes për fushatat shtetërore në nivelin shtetëror (në tekstin e mëtejme: Komisioni në nivel shtetëror) përbëhet nga:

- tre përfaqësues nga partitë politike të shumicës parlamentare në pushtet, të cilët mund të jenë anëtarë të Kuvendit, anëtarë partie ose pale të treta, nga të cilët dy përfaqësues të partise politike që ka numrin më të madh të deputeteve dhe një përfaqësues i partive politike që janë pjesë e shumicës parlamentare në pushtet, dhe

- tre përfaqësues nga partitë politike të opozitës parlamentare, të cilët mund të jenë anëtarë të Kuvendit, anëtarë partie ose pale të treta, nga të cilët dy përfaqësues të partise politike të opozitës parlamentare që ka numrin më të madh të deputeteve dhe një përfaqësues i parti politike që është e dyta për nga numri i deputeteve dhe është pjesë e opozitës parlamentare.

(2) Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës, në afat prej 30 ditësh nga dita e konstituimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonise së Veriut, u paraqet kërkesë partive politike sipas paragrafit (1) të këtij neni që t'i propozojnë përfaqësuesit e tyre të Komisionit në nivel shtetëror.

(3) Partitë politike i dorëzojnë propozimet Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës në afat prej 10 ditësh nga pranimi i kërkesës sipas paragrafit (2) të këtij neni. Partitë politike që nuk paraqesin propozime brenda afatit të caktuar nuk do të marrin pjesë në punën e Komisionit në nivel shtetëror.

(4) Ministri i Shoqërisë Informatike dhe të Administratës merr vendim për themelimin e komisionit në nivel shtetëror në afat prej 10 ditësh nga dita e dorëzimit të propozimeve sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Komisioni në nivel shtetëror fillon me punë në afat prej pesë ditësh nga dita e themelimit.

(6) Komisioni në nivel shtetëror mbledhet nga data 20 janar deri më 5 shkurt të vitit kalendarik.

(7) Mandati i komisionit në nivel shtetëror zgjat deri në konstituimin e përberjes së re të deputeteve të Kuvendit të Republikës së Maqedonise së Veriut.

(8) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, përberja e Komisionit në nivel shtetëror mund të ndryshohet nëse ka ndryshim të partive politike në opozitën parlamentare ose partive politike nga shumica parlamentare në pushtet në Kuvend të Republikës së Maqedonise së Veriut ose nëse dikush nga anëtarët ka dhënë dorëheqje.

(9) Me perjashtim te paragrafit (6) te ketij neni, ne rast te gjendjes ushtarake ose te jashtezakonshme, me qellim te parandalimit, paralajmerimit te hershem dhe ballafaqimit me kriza qe paraqesin rrezik per mallrat, shendetin, jeten e njerezve dhe kafsheve, te cilat jane te shkaktuara nga fatkeqesite natyrore dhe epidemite nga rreziqet tjera dhe kercnimeve qe kercenojne drejtperdrejt rendin kushtetues dhe sigurine e Republikes se Maqedonise se Veriut, me kerkese te se paku gjysmes se anetareve te numrit te pergjithshem te anetareve, Komisioni ne nivel shteteror mund te mblidhet shtese dhe te propozoje ndryshimin e vendimit te miratuar me pare per zgjedhjen e fushatave shteterore sipas paragrafeve (12) dhe (13) te ketij neni.

(10) Perfaqesuesit e partive politike nga shumica parlamentare ne pushtet dhe perfaqesuesit e partive politike te opozites parlamentare mund te paraqesin propozime per fushata shteterore ne nivel shteteror ne Komision ne nivel shteteror ne periudhen nga 1 deri me 20 janar.

(11) Komisioni ne nivel shteteror punon nese jane te pranishem me shume se gjysma e anetareve.

(12) Komisioni ne nivel shteteror eshte i obliguar qe ne periudhen sipas paragrafit (6) te ketij neni te pergatise vendim per zgjedhjen e fushatave shteterore dhe t'ia dorezoje Ministrise se Shoqerise Informatike dhe te Administrates per miratim.

(13) Me perjashtim, sipas paragrafit (12) te ketij neni, nese komisioni shteteror nuk e pergatit vendimin per zgjedhjen e fushatave shteterore, anetaret e Komisionit shteteror nga partia politike me shumice parlamentar qe ka numrin me te madh te deputeteve dhe anetaret e Komisionit ne nivel shteteror nga partia politike nga opozita parlamentare qe ka numrin me te madh te deputeteve mund te propozojne vetem nje zgjidhje per nje fushate shteterore ne nivel shteteror. Komisioni ne nivel shteteror pergatit vendimin per perzgjedhjen e fushatave shteterore brenda pese diteve nga dita e perfundimit te seances se Komisionit ne nivel shteteror dhe ia paraqet per miratim Ministrise se Shoqerise Informatike dhe te Administrates.

14) Vendimin sipas paragrafeve (12) dhe (13) te ketij neni e miraton ministri i Shoqerise Informatike dhe Administrates ne afat prej pese ditesh nga dita e dorezimit nga Komisioni ne nivel shteteror dhe ia dorezon Qeverise se Republika e Maqedonise se Veriut per shpalljen e thirrjes publike ne pajtim me nenin 101-c paragrafi (1) te ketij ligji.

(15) Per punen e tij, Komisioni ne nivel shteteror miraton rregulloren e punes ne afat prej 10 ditesh nga dita e formimit te saj.

(16) Per punen administrativo-profesionale dhe teknike per nevojat e Komisionit ne nivel shteteror, Ministria e Shoqerise Informatike dhe e Administrates formon grup pune nga punonjesit e saj.

Financimi i fushatave shteterore ne nivel shteteror

Neni 101-c

(1) Financimi i fushatave shteterore ne nivel shteteror sigurohet nga Buxheti i Republikes se Maqedonise se Veriut ne shume prej 0,1% nga te hyrat tatimore te realizuara te percaktuara ne llogarine perfundimtare te miratuar te fundit te Buxhetit te Republikes se Maqedonise se Veriut. Shperndarja e mjeteve kryhet si me poshte:

- me se shumti 7% jane per zgjedhjen e shtepive te produksioneve per perpunimin dhe produksionin e zgjidhjeve ideore dhe realizimet perfundimtare te fushatave shteterore, dhe - te pakten 93% jane per realizimin e fushatave shteterore.

(2) Mjetet per transmetimin e fushatave shteterore ne nivel shteteror sipas paragrafit (1) nenparagrafi 2 te ketij neni ndahen si vijon:

- 40% e mjeteve ne nivel vjetor ndahen per fushata shteterore ne nivel shteteror qe do te transmetohen vetem ne televizionet shteterore nepermjet nje operatori multipleks tokesor digjital dhe
- 40% e mjeteve ndahen cdo vit per fushatat shteterore ne nivel shteteror qe do te transmetohen vetem ne televizionet e nivelit shteteror nepermjet nje operatori te rrjetit publik te komunikimit elektronik, televizioneve satelitore dhe radiove te nivelit shteteror, dhe
- 15% e mjeteve ne nivel vjetor ndahen per fushatat shteterore ne nivel shteteror qe do te transmetohen vetem ne televizionet rajonale dhe lokale nepermjet nje operatori multipleks tokesor, si dhe nepermjet nje operatori te rrjetit publik te komunikimit elektronik dhe ne radio ne nivelin lokal dhe rajonal, dhe
- 5% e mjeteve ne nivel vjetor ndahen per fushata shteterore ne nivel shteteror qe do te transmetohen vetem ne radiot ne nivel shteteror.

(3) Mjetet per transmetimin e fushatave shteterore ne nivel shteteror sipas paragrafit (2) nenparagrafi 1 e ketij neni shperndahen ne menyre lineare te televizionet qe transmetojne program ne nivel shteteror nepermjet operatorit te multipleksit tokesor digjital ne nivel shteteror.

(4) Ndarjen e shumes se mjeteve sipas paragrafit (2) nenparagrafi 2, 3 dhe 4 te ketij neni per transmetimin e fushatave shteterore ne nivel shteteror te destinuara per televizione dhe radio, e ben Ministria e Shoqerise Informatike dhe e Administrates. sipas kriterëve te meposhtme:

- shumen e tatimeve, kontributeve dhe detyrimeve te tjera publike te paguara, per vitin e kaluar kalendarik, dhe
- numri i te punesuarve ne vitin e kaluar kalendarik qe kane pasur marredhenie pune te caktuar dhe te pacaktuar per te pakten gjashte muaj.

(5) Mjetet sipas paragrafit (1) te ketij neni sigurohen nga buxheti i Ministrise se Shoqerise Informatike dhe te Administrates.

(6) Kriteret sipas paragrafit (4) te ketij neni me hollesisht i percakton Agjencia per sherbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe i publikon ne ueb-faqen e saj.

Perzgjedhja e nje zgjidhjeje ideore per nje fushate shteterore ne nivel shteteror

Neni 101-c

(1) Per hartimin e zgjidhjes ideore dhe realizimin e nje fushate shteterore ne nivel shteteror, shtepia e produksionit zgjidhet nepermjet thirrjes publike te shpallur nga Qeveria e Republikes se Maqedonise se Veriut dhe fillon jo me vone se 10 dite nga dita e marrjes se vendimit sipas nenit 101-b, paragrafet (12) dhe (13) te ketij ligji.

(2) Per thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni, shtepia e produktionit e cila i ploteson keto kushte:

- te jete i regjistruar per kryerjen e veprimtarise ne pajtim me Ligjin e Shoqerive Tregtare se paku tre vjet para shpalljes se thirrjes publike sipas paragrafit (1) te ketij neni;
- se nuk ka ndalim per ushtrimin e profesionit, veprimtarise ose detyres;
- te kete paguar te gjitha tatimet, kontributet dhe te hyrat dhe detyrimet e tjera publike per vitin e kaluar kalendarik;
- te mos kete filluar procedura falimentimi ose likuidimi dhe
- te kete te pakten pese referenca per zbatimin e suksesshem te fushatave promovuese ne tre vitet e fundit.

(3) Me rastin e paraqitjes se ofertes per thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni, shtepia e produktionit dorezon ne Sekretariatin e Pergjithshem te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut deshmi per plotesimin e kushteve sipas paragrafit (2) te ketij neni, propozim per nje zgjidhje ideore dhe oferte financiare.

(4) Afati per paraqitjen e ofertes ne thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni eshte 10 dite nga dita e shpalljes se thirrjes publike.

(5) Propozim per zgjedhjen e shtepise se produktionit jep Komisioni per zgjedhjen e shtepise se produktionit per produksionin e nje fushate shteterore ne nivel shteteror (ne tekstin e metejme: Komisioni per zgjedhjen e shtepise se produktionit) i cili eshte themeluar nga Qeveria e Republikes se Maqedonise se Veriut.

(6) Komisioni sipas paragrafit (5) te ketij neni perbehet nga pese anetare te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut, nga te cilet jane edhe anetare te Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut te cilet jane kompetent per fushat qe jane te perfshira me vendimin sipas nenit 101-b paragrafet (12) dhe (13) te ketij ligji.

(7) Komisioni per zgjedhjen e shtepise se produktionit perгатit propozim vendim per zgjedhjen e shtepise se produktionit per realizimin e fushates shteterore ne nivel shteteror dhe ne afat prej 10 ia dorezon Qeverise se Republikes se Maqedonise se Veriut nga dita e perfundimit te afatit per dorezimin e ofertes ne thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni.

(8) Qeveria e Republikes se Maqedonise se Veriut vendimin sipas paragrafit (7) te ketij neni e merr ne afat prej 10 ditesh nga dita e dorezimit nga Komisioni per zgjedhjen e shtepise se produktionit.

(9) Shtepite e perzgjedhura te produktionit kane per obligim qe ne afat prej 20 ditesh nga dita e marrjes se vendimit sipas paragrafit (7) te ketij neni, ta perfundojne produksionin perfundimtar te fushates shteterore ne nivel shteteror dhe t'ia dorezojne Komisionit ne nivel shteteror.

(10) Komisioni ne nivel shteteror brenda 10 diteve nga dita e marrjes se produksionin perfundimtar per fushaten shteterore ne nivel shteteror e miraton dhe ia dorezon Ministrise se Shoqerise Informatike dhe te Administrates, me qellim dorezimin tek radiodifuziesit e perzgjedhur ne pajtim me nenin 101-d paragrafi (6) te ketij ligji.

(11) Per pune administrative-profesionale dhe teknike per nevojat e Komisionit per zgjedhjen e shtepise se produktionit, sekretari i Pergjithshem i Qeverise se Republikes se Maqedonise formon grup punues nga radhet e nepunesve administrativ te Sekretariatit te Pergjithshem te Qeveria e Republikes se Maqedonise se Veriut.

Cmimoret e emetimit

Neni 101-d

(1) Radiodifuzuesit janë të obliguar të përcaktojnë cmimoret për transmetimin e fushatave shtetërore në nivel shtetëror jo më vonë se 10 ditë nga dita e shpalljes së thirrjes publike sipas nenit 101-d paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Cmimtarët sipas paragrafit (1) të këtij neni publikohen në uebfaqet e radiodifuzuesve dhe i dërgohen Agjencisë së Sherbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonise së Veriut, Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe të Administratës, si dhe në Komisionin e nivelit shtetëror.

(3) Me rastin e përcaktimit të cmimeve për secilën media vec e vec nga radiodifuzuesit për transmetimin e fushatave shtetërore në nivel shtetëror, cmimi mesatar për sekonde për një ditë dhe natë llogaritet sipas periudhave të ndryshme kohore të reklamimit të cmimeve, përkatesisht:

- periudha 1 nga ora 00.00-08.00,
- periudha 2 nga ora 08.00-16.00,
- periudha 3 nga ora 16.00-24.00.

(4) Cmimi mesatar sipas paragrafit (3) i këtij neni nuk duhet të kalojë cmimin mesatar të përgjithshëm të reklamave komerciale të secilit transmetues të llogaritur vecmas në gjashtë muajt e fundit nga fillimi i çdo viti kalendarik i rritur me së shumti për 80% dhe jo më i lartë se cmimi maksimal i shitur i marketingut nga viti i kaluar.

Zbatimi i fushatës shtetërore në nivel shtetëror

Neni 101-gj

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonise së Veriut publikon thirrje publike për pjesëmarrje për realizimin e fushatës shtetërore në nivel shtetëror, në të cilën kriteret shpallen për pjesëmarrje sipas paragrafit (2) të këtij neni, shuma e mjeteve të ndara dhe menyra e shpërndarjes së tyre.

(2) Transmetuesit që përmbushin kriteret e mëposhtme kanë të drejtë të marrin pjesë në zbatimin e një fushate shtetërore në nivel shtetëror:

- të jetë i regjistruar për kryerjen e veprimtarisë në pajtim me Ligjin e Shoqërive Tregtare së paku tre vjet para shpalljes së thirrjes publike sipas paragrafit (1) të këtij neni;
- të mos ketë ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- të ketë paguar të gjitha taksat, kontributet dhe detyrimet e tjera publike për vitin e kaluar kalendarik;
- të mos ketë filluar procedurë falimentimi ose likuidimi;
- të plotësojë kërkesat e Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësirë, financiare dhe të personelit për marrjen e licencës për transmetim radioteleviziv.
- të dorëzojë cmimorën sipas nenit 101-d të këtij ligji.

(3) Radiodifuzuesit qe nuk i plotesojne te gjitha kriteret sipas paragrafit (2) te ketij neni nuk kane te drejte te transmetojne fushata shteterore ne nivel shteteror ne programin e tyre dhe mjetet per ate transmetues qe jane te destinuara ne pajtim me nenin 101-v te ketij ligji nuk u shperndahen transmetuesve te tjere.

(4) Radiodifuzuesit do t'i dorezojne deshmite e kerkuara per permbushjen e kriterave nga paragrafi (2) te ketij neni, Komisionit ne nivel shteteror ne afat prej 10 ditesh nga dita e shpalljes se thirrjes publike sipas paragrafit (1) te ketij neni. Komisioni ne nivel shteteror kontrollon permbushjen e kriterave brenda 15 diteve nga perfundimi i afatit per dorezimin e deshmive te kerkuara dhe i dorezon Ministrise se Shoqerise Informatike dhe te Administrates listen e radiodifuzuesve qe plotesojne kriteret.

(5) Qeveria e Republikes se Maqedonise se Veriut miraton vendim per zbatimin e fushates shteterore ne nivel shteteror, ne te cilin listohen radiodifuzuesit e perzgjedhur qe i plotesojne kriteret sipas paragrafit (2) te ketij neni, si dhe shuma e mjeteve te ndara per radiodifuzuesit.

(6) Ministria e Shoqerise Informatike dhe te Administrates ua dorezon produksionin per fushatat shteterore ne nivel shteteror radiodifuzuesve te perzgjedhur ne afat prej 10 ditesh nga dita e miratimit te vendimit sipas paragrafit (5) te ketij neni.

(7) Fushata shteterore ne nivel shteteror qe transmetohet ne nje program televiziv duhet te shenohet ne menyre te pershtatshme dhe te dukshme vizualisht ne kendin e poshtem djathtas si "Fushate shteterore" dhe te ndahet qarte nga permbajtjet e tjera te programit televiziv, dhe ne rastin e programeve radiofonike, e shenuar me ze si nje xhingell radioje.

(8) Mjetet sipas nenit 101-v te ketij ligji per financimin e fushatave shteterore ne nivel shteteror paguhet jo me vone se 30 dite nga dita e perfundimit te fushates shteterore ne nivel shteteror, ne baze te fatures, planit mediatik dhe raportit per sherbimet e realizuara te dorezuara nga radiodifuzuesit ne Ministrine e Shoqerise Informatike dhe te Administrates.

(9) Radiodifuzuesit ia dorezojne Agjencise se Sherbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale planin mediatik dhe raportin per sherbimet e realizuara dhe i publikojne ne ueb-faqet e tyre brenda 30 diteve nga perfundimi i fushates shteterore ne nivel shteteror".

Kapitulli V-b FUSHATA SHTETERORE NE NIVEL LOKAL

Fushata shteterore ne nivel lokal

Neni 101-e

(1) Njesite e veteqeverisjes lokale mund te zbatojne me se shumti kater fushata shteterore ne nivel lokal gjate nje viti kalendarik.

(2) Vendim per realizimin e fushatave shteterore ne nivel lokal miraton keshilli i komunes, Keshilli i Komunes ne Qytetin e Shkupit dhe Keshilli i Qytetit te Shkupit (ne tekstin e metejme: Keshilli), jo me vone se 15 nentori ne vitin vijues per vitin e ardhshem dhe fondet per realizimin e fushatave te fushatave shteterore ne nivel lokal jane pjese perberese e buxhetit te njesise se veteqeverisjes lokale.

Komisioni per vendimarrje per fushatat shtetere ne nivel lokal

Neni 101-zh

- (1) Pas miratimit te vendimit nga neni 101-e paragrafi (2) te ketij ligji, Keshilli themelon Komisionin e vendimarrjes per fushatat shtetere ne nivel lokal (ne tekstin e metejme: Komisioni ne nivel lokal).
- (2) Komisioni ne nivel lokal perbehet nga anetare te Keshillit dhe perberja korrespondon me perfaqesimin proporcional te partive politike ne Keshill.
- (3) Propozimet e anetareve per themelimin e Komisionit ne nivel lokal nga ky nen i japin palet sipas paragrafit (2) te ketij neni dhe i konfirmon Keshilli.
- (4) Komisioni ne nivel lokal nga ky nen do te themelohet me se voni ne afat prej 10 ditesh nga dita e miratimit te vendimit sipas nenit 101-e paragrafi (2) te ketij ligji.
- (5) Komisioni ne nivel vendor kryeson nga data 20 janar deri me 5 shkurt te vitit kalendarik.
- (6) Mandati i Komisionit ne nivel lokal sipas paragrafit (1) i ketij neni zgjat deri ne konstituimin e perberjes se re te Keshillit.
- (7) Anetaret e Keshillit mund te paraqesin propozime per tema per fushatat shtetere ne nivel lokal ne Komisionin ne nivel lokal ne periudhen nga 1 deri me 20 janar.
- (8) Komisioni ne nivel lokal eshte i detyruar qe ne periudhen sipas paragrafit (5) te ketij neni te pergatise vendim per zgjedhjen e fushatave shtetere ne nivel lokal dhe t'ia dorezoje Keshillit per miratim.
- (9) Me perjashtim te paragrafit (5) te ketij neni, ne rast te gjendjes lufte ose te jashtezakonshme, me qellim te parandalimit, paralajmerimit te hershem dhe ballafaqimit me krizat qe paraqesin rrezik per asetet, shendetin dhe jeten e njerezve dhe kafsheve dhe shkaktohen nga fatkeqesite natyrore dhe epidemite ose rreziqet dhe kercenimet tjera qe kercenojne drejtperdrejt rendin kushtetues dhe sigurine e Republikes se Maqedonise se Veriut, me kerkese te gjysmes se anetareve te numrit te pergjithshem te anetareve, Komisioni ne nivel lokal mund te takohen dhe propozojne ndryshimin e vendimit te miratuar me pare sipas paragrafit (8) te ketij neni dhe t'ia dorezojne Keshillit per miratim.
- (10) Vendimin sipas paragrafeve (8) dhe (9) te ketij neni e miraton Keshilli ne afat prej pese ditesh nga dita e dorezimit nga Komisioni ne nivel lokal.
- (11) Per punen e vet, Komisioni ne nivel vendor miraton rregulloren e punes brenda 10 diteve nga dita e themelimit i tij.

Financimi i fushatave shtetere ne nivel lokal

Neni 101-z

- (1) Financimi i fushatave shtetere ne nivel lokal sigurohet nga buxheti i njesise se veteqeverisjes lokale ne masen deri ne 0,5% te te ardhurave tatimore te realizuara te veta, te percaktuara ne llogarine perfundimtare te miratuar me heret. Shperndarja e mjeteve kryhet si me poshte:

- Me se shumti 10% jane per perzgjedhjen e shtepive produksioni per perpilimin dhe prodhimin e zgjidhjeve ideore dhe realizimet perfundimtare te fushatave shteterore ne nivel lokal.
- te pakten 90% jane per realizimin e fushatave shteterore ne nivel lokal.

(2) Mjetet per transmetimin e fushatave shteterore ne nivel lokal sipas paragrafit (1) nenparagrafi 2. te ketij neni, i shperndan Komisioni ne nivel lokal, ne menyren e meposhtme:

- nga 50% ne 75% te mjeteve ne nivel vjetor jane per fushatat shteterore ne nivel lokal qe do te transmetohen vetem ne televizionet shteterore nepermjet nje operatori publik te rrjetit te komunikimit elektronik, nepermjet satelitit, televizioneve te nivelit rajonal nepermjet nje operatori publik i rrjetit te komunikimit elektronik i cili nuk perdor burime te kufizuara, si dhe televizionet ne nivel rajonal nepermjet nje operatori multipleks tokesor digjital, televizionet ne nivel lokal dhe radiot ne nivel shteteror, rajonal dhe lokal dhe
- nga 25% deri ne 50% te mjeteve ne nivel vjetor jane per fushatat shteterore ne nivel lokal qe do te transmetohen vetem ne televizionet shteterore nepermjet nje operatori multipleks tokesor digjital.

(3) Shperndarjen e shumes se mjeteve per transmetimin e fushatave shteterore sipas paragrafit (2) nenparagrafi 1 te ketij neni, te dedikuara per televizionet dhe radiot, e kryen Keshilli me propozimin e Komisionit ne nivel lokal, sipas kriterëve te meposhtme: :

- shuma e tatimeve, kontributeve dhe detyrimeve te tjera publike te paguara, per vitin e kaluar kalendarik dhe
- numri i te punesuarve ne vitin e kaluar kalendarik te cilet kane pasur nje marredhenie pune ne kohe te caktuar dhe te pacaktuar per te pakten gjashte muaj.

(4) Kriteret sipas paragrafit (3) te ketij neni me ne detaje i percakton Agjencia e Sherbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe i publikon ne ueb-faqen e saj.

(5) Mjetet per transmetimin e fushatave shteterore ne nivel lokal sipas paragrafit (2) nenparagrafi 2 e ketij neni shperndahen ne menyre lineare te stacionet televizive qe transmetojne programe ne nivel shteteror nepermjet operatorit te multipleksit tokesor digjital.

Perzgjedhja e nje zgjidhje ideore dhe produksioni per fushate shteterore ne nivel lokal

Neni 101-x

(1) Per hartimin e zgjidhjes ideore dhe produksionin e nje fushate shteterore ne nivel lokal, zgjidhet shtepia produksioni me thirrje publike qe e shpall kryetari i komunes, kryetari i komunes se qytetit te Shkupit ose kryetari te qytetit te Shkupit, dhe fillon me se voni 10 dite nga dita e marrjes se vendimit ne pajtim me nenin 101-zh paragrafet (8) dhe (9) te ketij ligji, nga Keshilli.

(2) Ne thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni mund te paraqitet shtepia e produksionit e cila i ploteson kushtet ne vijim:

- te jete e regjistruar per kryerjen e veprimtarise ne pajtim me Ligjin e Shoqerive Tregtare se paku tre vjet para publikimit te thirrjes publike sipas paragrafit (1) te ketij neni;
- te mos kete ndalese per ushtrimin e profesionit, veprimtarise ose detyres;

- te kete paguar te gjitha tatimet, kontributet dhe detyrimet e tjera publike per vitin e kaluar kalendarik;
- te mos kete nisur procedure falimentimi apo likuidimi dhe
- te kete te pakten pese referenca per zbatimin e suksesshem te fushatave promovuese ne tre vitet e fundit.

(3) Shtepia e produksionit gjate dorezimit te ofertes per thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni ne komunen ose qytetin e Shkupit, paraqet deshmi per permbushjen e kriterave sipas paragrafit (2) te ketij neni, propozim per zgjidhje ideore dhe oferte financiare.

(4) Afati per dorezimin e ofertes ne thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni eshte 10 dite nga dita e publikimit te thirrjes publike.

(5) Perzgjedhja e nje shtepie te produksionit per produksionin e nje fushate shtetere ne nivel lokal behet me vendim te Keshillit, me propozimin e Komisionit ne nivel lokal brenda 10

diteve nga perfundimi i afatit per dorezimin e ofertes ne thirrjen publike sipas paragrafit (1) te ketij neni.

(6) Per punet administrativo-profesionale dhe teknike per nevojat e Komisionit ne nivel lokal, kryetari i komunes formon grup punues nga radhet e nepunesit administrative ne komune.

(7) Shtepite e perzgjedhura te produksionit kane detyrim qe ne afat prej 20 ditesh nga dita e miratimit te vendimit sipas paragrafit (5) te ketij neni, te perfundojne prodhimin perfundimtar te fushates shtetere dhe t'ia paraqesin Keshillit.

Cmimore e emetimit

Neni 101-i

(1) Radiodifuzuesit jane te obliguar te percaktojne cmimoret per transmetimin e fushatave shtetere ne nivel lokal, jo me vone se 10 dite nga dita e shpalljes se thirrjes publike sipas nenit 101-x paragrafi (1) te ketij ligji.

(2) Cmimoret sipas paragrafit (1) i ketij neni publikohen ne uebfaqet e radiodifuzuesve dhe i dorezohen Agjencise se Sherbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Keshillit.

(3) Me rastin e percaktimit te cmimoreve per secilen media vec e vec nga radiodifuzuesit per transmetimin e fushatave shtetere ne nivel lokal, cmimi mesatar per sekonde per nje dite dhe nate llogaritet sipas periudhave te ndryshme kohore te reklamimit te cmimeve, perkatesisht:

- periudha 1 nga ora 00:00-08:00,
- periudha 2 nga ora 08:00-16:00,
- periudha 3 nga ora 16:00-24:00.

(4) Cmimi mesatar sipas paragrafit (3) i ketij neni nuk duhet te kaloje cmimin mesatar te pergjithshem te reklamave komerciale te secilit transmetues te llogaritur vecmas ne gjashte muajt e fundit nga fillimi i cdo viti kalendarik l rritur me se shumti per 80% dhe jo me i larte se cmimi maksimal i shitur i marketingut nga viti i kaluar.

Zbatimi i fushates shtetere ne nivel lokal

Neni 101-j

(1) Keshilli publikon thirrje publike per pjesemarrje per realizimin e fushates shtetere ne nivel lokal, ne te cilen kriteret shpallen per pjesemarrje sipas paragrafit (2) te ketij neni, shuma e mjeteve te ndara dhe menyra e shperndarjes se tyre.

(2) Radiodifuzuesit qe permbushin kriteret e meposhtme kane te drejte te marrin pjese ne zbatimin e nje fushate shtetere ne nivel lokal:

- te jete i regjistruar per kryerjen e veprimtarise ne pajtim me Ligjin e Shoqerive Tregtare se paku tre vjet para shpalljes se thirrjes publike sipas paragrafit (1) te ketij neni;
- te mos kete ndalim per kryerjen e profesionit, veprimtarise ose detyres;
- te kete paguar te gjitha taksat, kontributet dhe detyrimet e tjera publike per vitin e kaluar kalendarik;
- te mos kete filluar procedure falimentimi ose likuidimi;
- te plotesoje kerkesat e Rregullores per kushtet minimale teknike, hapesine, financiare dhe te personelit per marrjen e licences per transmetim radioteleviziv, dhe - te dorezoje cmimoren sipas nenit 101-i te ketij ligji.

(3) Radiodifuzuesit qe nuk i plotesojne te gjitha kriteret sipas paragrafit (2) te ketij neni nuk kane te drejte te transmetojne fushata shtetere ne nivel lokal ne programin e tyre dhe mjetet per ate radiodifuzues qe jane te dedikuara ne pajtim me nenin 101-z te ketij ligji nuk u shperndahen radiodifuzuesve te tjere.

(4) Radiodifuzuesit do t'i dorezojne deshmite e kerkuara per permbushjen e kriterave nga paragrafi (2) te ketij neni, Komisionit ne nivel lokal ne afat prej 10 ditesh nga dita e shpalljes se thirrjes publike sipas paragrafit (1) te ketij neni. Komisioni ne nivel lokal kontrollon permbushjen e kriterave brenda 15 diteve nga perfundimi i afatit per dorezimin e deshmive te kerkuara dhe i dorezon Keshillit per miratim listen e radiodifuzuesve qe plotesojne kriteret.

(5) Keshilli ne afat prej 10 ditesh nga data e dorezimit te listes sipas paragrafit (4) i ketij neni, miraton vendim per zbatimin e fushates shtetere ne nivel lokal, ku shpallet lista e radiodifuzuesit e perzgjedhur qe i plotesojne kriteret sipas paragrafit (2) te ketij neni shpallet edhe shuma e mjeteve te ndara dhe ua dorezon produksioni radiodifuzuesve te perzgjedhur.

(6) Fushata shtetere ne nivel lokal qe transmetohet ne nje program televiziv duhet te shenohet ne menyre te pershtatshme dhe te dukshme vizualisht ne kendin e poshtem djathtas si "Fushate shtetere" dhe te ndahet qarte nga permbajtjet e tjera te programit televiziv dhe ne rastin e programeve radiofonike, e shenuar me ze si nje xhingell radioje.

(7) Mjetet sipas nenit 101-z te ketij ligji per financimin e fushatave shtetere ne nivel lokal paguhen jo me vone se 30 dite nga dita e perfundimit te fushates shtetere ne nivel lokal, ne baze te fatures, planit mediatik dhe raportit per sherbimet e realizuara te dorezuara nga radiodifuzuesit ne komunen, komunen e qytetit te Shkupit ose Qytetit te Shkupit.

(8) Radiodifuzuesit ia dorezojne Agjencise se Sherbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale planin mediatik dhe raportin per sherbimet e realizuara dhe i publikojne ne uebfaqet e tyre brenda 30 diteve nga perfundimi i fushates shtetere ne nivel lokal".

Neni 7

Neni 102 fshihet.

Neni 8

Titulli i nenit 105 ndryshohet dhe behet:

"Financimi i RTM-se, NP "Radiodifuzioni i Maqedonise", Agjencia per Sherbime Mediale Audio dhe Audiovizuale"

Neni 9

Ne nenin 141 paragrafi (4) ndryshohet dhe behet:

(4) Me fletëparaqitjen, personi përgjegjës i operatorit paraqet:

- deklarate që konfirmon nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se për ritransmetimin e shërbimeve programore sipas paragrafit (2) nënparagrafi 3 të këtij neni është rregulluar e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta, në përputhje me rregulloret për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta.
- kopje të notërizuar të kontratave për ritransmetimin e shërbimeve programore nga neni 143 paragrafi (2) i këtij ligji, me të cilat rregullohet e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta, në pajtim me rregulloret për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta."

Në paragrafin (11), pas fjaleve "deklarate e re" shtohen fjalet "dhe një kopje të notërizuar të kontratës së re për ritransmetim të shërbimeve programore".

Neni 10

Pas nenit 141 shtohet titulli i ri dhe neni i ri 141-a, siç vijon:

"Ritranstmetimi i shërbimeve programore që transmetohen në një multipleks tokësor digjital

Neni 141-a

(1) Radiodifuzuesit që transmetojnë shërbime programore nëpërmjet kapacitetit transmetues të një multipleksi tokësor digjital janë të detyruar të ofrojnë lidhjen e një kontrate për ritransmetimin e shërbimeve të tyre programore për të gjithë operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik.

(2) Radiodifuzuesit nga paragrafi (1) te ketij neni jane te detyruar t'u shpallin thirrje publike te gjithë operatoreve te rrjeteve publike te komunikimit elektronik per te lidhur kontrate per ritransmetim te serviseve programore.

(3) Radiodifuzuesit sipas paragrafit (1) te ketij neni kane te drejte ne kompensim per ritransmetimin e sherbimeve te tyre programore nga operatorët e rrjeteve publike te komunikimit elektronik.

(4) Radiodifuzuesit sipas paragrafit (1) te ketij neni dhe operatorët e rrjeteve publike te komunikimit elektronik, te cilet do te pajtohen per ritransmetimin e serviseve programore, i rregullojne marredheniet e tyre me kontrate te lidhur ne perputhje me rregulloret per te drejten e autorit dhe te drejtat e peraferta dhe rregulloret tjera qe rregullojne marredheniet kontraktuese dhe e detyrimeve."

Neni 11

Ne nenin 143 paragrafi (1) ndryshohet dhe behet:

"(1) Operatori mund te ritransmetoje sherbime programore te radiodifuzuesve vendas vetem ne zonen e sherbimit per te cilen transmetuesit kane marre licencen per te ofruar transmetim televiziv ose radio dhe ne baze te te drejtes se rregulluar te autorit dhe te drejtave te peraferta ne perputhje me rregulloret per te drejten e autorit dhe te drejtat e peraferta, dhe ne rastin e ritransmetimit te sherbimeve programore te radiodifuzuesve vendas qe transmetohen nepermjet kapacitetit transmetues te nje multipleksi tokesor digjital dhe ne baze te nje kontrate te lidhur ne perputhje me nenin 141-a te ketij ligji".

Paragrafi (2) ndryshohet dhe behet:

"(2) Operatori mund te ritransmetoje sherbime programore ne radio transmetues nga shteti tjeter ne territorin e Republikes se Maqedonise se Veriut ne pajtim me nenin 44 te ketij ligji dhe ne baze te marreveshjes per rregullimin e te drejtes se autorit dhe te drejtave te peraferta, ne perputhje me rregulloret per te drejten e autorit dhe te drejtat e peraferta."

Neni 12

Ne nenin 147, paragrafi (1), pas pikes 21), shtohen dy pika te reja 22) dhe 23), sic vijon:

"22) radiodifuzuesi nuk e dorezon raportin nga neni 101-a paragrafi (3) i ketij ligji.

23) transmetuesit nuk e dorezojne planin medial dhe raportin per sherbimet e ofruara sipas nenit 101-gj paragrafi (9) dhe neni 101-j, paragrafi (8) te ketij ligji".

Ne paragrafin (3) fjalet "pika 11)" zevendesohen me fjalet "pika 12)"

Neni 13

Ne nenin 148, paragrafi (1) ne piken 11 fjalet "(neni 56, paragrafi (9))" zevendesohen me fjalet "(neni 56 paragrafi (6))".

Ne piken 14, fjalet "(1) dhe (2)" zevendesohen me fjalet "(1), (2) dhe (3)".

Ne piken 33) fjalet "neni 144-d paragrafi (4)" zevendesohen me fjalet "neni 144-e paragrafi (4)".

Ne paragrafin (2), pas fjaleve: "personi pergjegjes i programit ne personin juridik" vihet presje dhe shtohen fjalet "personi pergjegjes ne personin juridik".

Neni 14

Ne nenin 149 paragrafi (1) ne piken 6 fjalet "(neni 60 paragrafi (2))" zevendesohen me fjalet "(neni 60 paragrafi (3))".

Ne piken (8), pas fjaleve "(neni 98 paragrafi (1))" shtohen fjalet "dhe nuk i respekton rregullat per teknikat e reja te reklamimit (neni 98 paragrafi (2))".

Pika 9), ndryshohet dhe behet:

"9) nuk vepron ne pajtim me dispozitat e nenit 100 paragrafi (1) te ketij ligji".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Me gjobe prej 250 euro ne kundervlere ne denare do t'i shqiptohet edhe tregtarit individual edhe personit fizik per kryerjen e kundervajtjes sipas paragrafit (1) te ketij neni".

Dispozitat kalimtare dhe perfundimtare

Neni 15

(1) Ministria e Shoqerise Informatike dhe e Administrates eshte e detyruar qe brenda 60 diteve nga hyrja ne fuqi e ketij ligji te formoje Komisionin e vendimmarrjes per fushaten shtetere ne nivel shtetor, i cili do te kryeje punen e tij deri ne formimin e Komisionit ne perputhje me nenin 101-b te ketij ligji.

(2) Per formimin e komisioneve sipas paragrafit (1) i ketij neni, Ministria e Shoqerise Informatike dhe e Administrates i paraqet kerkese partise politike te shumices parlamentare qeverisese dhe partise politike te opozites parlamentare per paraqitjen e perfaqesuesit brenda 10 diteve nga dita e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

(3) Propozimet qe anetaret e Komisionit sipas paragrafit (1) te ketij neni u japin paleve sipas paragrafit (2) te ketij neni ne afat prej 30 ditesh nga dita e pranimit te kerkeses sipas paragrafit (2) te ketij neni.

(4) Komisioni ne nivel shtetor fillon te punoje brenda 10 diteve nga dita e formimit te tij.

(5) Perfaqesuesit e partive politike nga qeveria si shumice parlamentare dhe perfaqesuesit e partive politike te opozites parlamentare i dorezojne komisioneve shtetore propozime per fushaten shtetore ne nivel shtetor brenda 10 diteve nga dita e formimit te Komisionet e nivelit shtetor.

Neni 16

Radiodifuzuesit qe transmetojne sherbime programore nepermjet kapacitetit transmetues te multipleksit digjital tokesor do ta shpallin thirrjen publike sipas nenit 141-a paragrafi (2) te ketij ligji ne afat prej tre muajsh nga data e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 17

Aktet nenligjore te percaktuara me kete ligj do te miratohen brenda 90 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij ligji.

Neni 18

Ky ligj hyn ne fuqi dite e tete nga dita e publikimit ne Gazeten Zyrtare te Republikes se Maqedonise se Veriut.